



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.324/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Ramush Bardiqi dhe Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 05.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.324/2025 e datës 03.02.2025, ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 02 shkurt 2025, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht ministër i Ministrisë së Bujqësisë z. Faton Peci në tubimin e partisë Guxo, të mbajtur në Hotel Emerald, në fjalimin e mbajtur në këtë tubim, ndër të tjerash deklaroi : *“Edhe në funksion të kësaj na duhet legjitimitet i plotë më datën 09 shkurt, sot një javë, përveç tjerash se unë e them që ata që e përfaqësojnë partitë opozitare, ose koalicioni i tyre PLANC nënkupton vota për ta, nënkupton rikthimin e Radioçiqit në veri, këmbëkryq në Kyreministri, Listën Serbska në Ministri të Bujqësisë edhe lulëzimin e korrupsionit në çdo institucion të çdo ministrie, andaj në veprimet e z. Faton Peci sipas parashtruesit të ankesës janë konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar të përcaktuar në nenin 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e*

Kosovës, i cili shprehimisht thotë *“përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur : CD me Përmbajtje të videoincizimit të fialimit në tubimin e mbajtur nga partia Guxo, në Hotel Emerald në Prishtinë, në të cilën, z. Faton Peci përdorë shprehje fyese, urrejtëse, denigruese, përçarëse dhe nxitëse ndaj subjekteve kundërshtare politike https://www.facebook.com/atch/live/?mibextid=wwLfr&ref=atch_permalink=134356485997688&id=TzR7BBCRVa2e40T, si dhe ftesën publike e publikuar nga partia Guxo.

Më datë 03.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 03.02.2025 në ora 18:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 03.02.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) duke theksuar se Ministri Peci gjatë tubimit të subjektit Guxo në Hotel Emerald me 2 shkurt 2025, brenda gjuhës elektorale dhe rregullave përkatse zgjedhore ka përdorur fakte të cilat veçse janë të ditura, pra deklarata e z. Peci nuk është asgjë tjetër pos një përshkrim i një të vërtete dhe e njëjta gjuhë nuk mund të futet në kategorinë e nxitjeve, ofendimeve dhe denigrimeve ngase e njëjta i përket premtimeve të luftimit të fenomeneve të këqija dhe premtimeve elektorale.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli, pas shikimit të video incizimit të ofruar si provë materiale e cila është publikuar shihet kandidati për deputet nga radhët e LVV-së – aktualisht ministër i Ministrisë së Bujqësisë z. Faton Peci ku i është drejtuar elektoratit të tij në Hotel Emerald duke përdor fjalët *“ Edhe në funksion të kësaj na duhet legjitimitet i plotë më datën 09 shkurt, sot një javë, përvec tjerash se unë e them që ata që e përfaqësojnë partitë opozitare, ose koalicioni i tyre PLANC nënkupton vota për ta, nënkupton rikthimin e Radioçiqit në veri, këmbkryq në Kyreministri, Listën Serbska në Ministri të Bujqësisë edhe lulëzimin e korrupsionit në cdo institucion të cdo ministrie”* dhe ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhën denigruese dhe urrejtjes në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Diskursi i tillë i përdorur nga kandidati Faton Peci hyn në diskursin e fushatës zgjedhore dhe nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon një person tjetër për të kryer një akt dhune kundër personave të tjerë ose pasurisë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11 e LZP, ku decidivisht theksohet se: *Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetsi ose kandidatët e tij ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijm :përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose*

pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxis urrejtje kundër të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me në fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11 përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtjen kundrejt tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.

Andaj Paneli bazuar në provat e ofruara ka ardhur në përfundim se gjatë mbajtjes së fushatës zgjedhore kandidati për deputet Faton Peci nuk ka përdor gjuhën që bie në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11 e LZP.

Nga arsyet e cekura u vendos si në dispozitiv.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 324/2025 më datë 05.02.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.